

*V. Sharrin's Konominif
Kafin*

VITI i IV — PRILL 1932 — Nr. 4

NORMALISTI

Jo në dijën, por në
vullnetin e fortë
qëndron vlera
e njeriut.

HERBART.

Drejtimi:
E përkohëshmeja "NORMALISTI,"
Shkolla Normale
Elbasan.

Shtypshkronja "SAIDE," Elbasan
1932

M b r e n d i j a

Friedrich Fröbeli	Faqe	1
Karakteri e edukata kombëtare	"	5
Pavarnija	"	7
Ndjenjat esthetike	"	9
Vorfënia e jonë letrare	"	10
Provë mësimi - Kallzim	"	13
Provë mësimi — Të larit e rrobeve	"	15
Provë mësimi — Kopshtari e punët e 'tij	"	17
Novelë — Ah, nënat!	"	19
Atje ku dirgjen dëshmorët	"	22
Lajme të Shkollës	"	24
Posta e jonë		

E përkohëshmjia "NORMALISTI", DEL NJI HERË NË MUEJ.

E botojnë nxënësit e Normales.

Editor:	H. Ballshi	'32.	ndihmës	S. Alliu	'33.
Sekretar:	I. Shishmani	'32.	" "	Q. Guranjaku	'33.
Arkëtar:	Y. Berisha	'32.	" "	K. Jovani	'34.

P a j t i m i : për gjashtë numra 2 Fr. ari
Nji numër kushton 2 Lekë.

Për kujtim e nderim
ky numër i Normalistit i kushtohet
pedagogut të math gjerman, krijuesit të
kopshtit fëminuer, Friedrich Frœ-
belit, i cili në këtë muej mbushi nji-
qind e pesdhetë vjetorin e lindjes së 'tij.

Friedrich Frœbeli.

1782 — 1852

Në muejin Prill të këtij viti gjithë bota arsimore po krem-
ton të njëqind e pesdhetën vjetë të lindjes së Friedrich Frœbelit,
i cili "me një shpejtsi mëndjeje të çuditshme e me një fuqi thjesh-
tsije, sikurse thotë Michelet, ka gjetë atë qi më kot e kërkojshin
dijëtarët: misterin e edukatës, kopshtin fëminuer,„.

Friedrich Frœbeli jeton në parafytyrimet t'ona si krijuesi
i kopshtit fëminuer, si pedagogu i fëminis së parë e si shkrimtar
i thellë i lojnavë të fëmijëve.

Leu më 21 Prill 1782 n' Oberweissbach, në Thuringen,
si bir i njëj prifti protestan. Po thue posa leu, humbi t'amen e u-
rrit prej t'et.

Frœbeli, qysh kur ishte fëmi, çfaq një pjerrje të madhe
për mistikizmin e një entusiasëm të gjallë për veprat e natyrës,
nga harmonija e çuditshme e së cilës, nxorri më vonë
ligjin e së mirës. Pjesa e parë e jetës së Frœbelit tregon një
paqindrueshmi mëndjeje. Tue qenë i paqindrueshëm në pëlqimet
e 'tij, nuk din me se të merret një herë e mirë. Nuk mendon
për t'ardhmen, i vorfën sikurse Pestalozzi; ai është aty për aty
rojtës pyjesh, natyralist, arqitekt, mësues privat, dhe kështu
vijon të baje gjithfarë punësh, deri në ditën kur i u-çfaq me
fuqi të madhe pjerrja e 'tij për mësuesi. Prandaj i ra puna me

studjue drejtsi, mineralogji, bujqësi, matematikë.

Më 1805 filloi karrierën e 'tij të mësuesis; në këtë kohë ishte 23 vjeçë. Pedagogu Grüner i dha atij një punë mësuesije në shkollën e 'tij modele qi drejtonte. Mbas disa ditësh i shkruente vëllaut të vet, Christophe-it: "Asht për t' u çuditë se sa fort më pëlqejnë punët e këtushme. Qysh prej mësimit të parë më ngjau sikur të mos kishje bëmë kurrgjã t' jetër veç kësaj, edhe pashë se isha lindë për këtë. Unë nuk mundem më me kujtuem në se kam mendue përpara për ndonji karierë t' jetër veç kësaj; e me gjithë atë, më thënë të drejtën, kurrë nuk më ka ramë ndër mënd qi të bëhem mësues .. Sa qe gjallë ai pati një dashuni të veçantë për mësuesin, për të cilën i dukej sikur e kishte caktue natyra vetë.

Më 1808 shkoi n' Herten bashkë me tre nxânës të 'tij edhe aty ndëjti dy vjetë, tue marrë pjesë në punët e institutit e tue futë në punë metodën e Mjeshtrit të Math, Pestalozzit. Në fillim nuk bëni gjã t' jetër veçse të zbatojë pikë për pikë parimet e Pestalozzit; medje edhe në shum pika ngeli më vonë dishepuil besnik i 'tij Intuita asht parimi themeluer i metodës së 'tij, e mund të thohet se mundi i 'tij pedagogjik qindron sidomos në të sistematizuemit e intuitave të ndijshme, qi Pestalozzi ia paraqiste fëmijës si më të qilluem e pa ndonji plan të caktuem.

Më 1811 u-çfaq origjinaliteti i Fröbelit me botimin e veprës së parë " **Traktati sferik** ", në të cilën gjën marradhânje misterioze ndërmyet sferës e botës shpirtnore.

" Tue këndue " Traktatin sferik " të Fröbelit, thotë Compayré, e ndia njeriu vehtën e vet të shtërngu m të pyesi, në se kemi të bájme me një mëndje të peshueme, a mos ndonji fantazi e teprueme ia ka humbë auktorit kuptimin e njimëndësis ..

Si mbas Fröbelit sfera asht forma ideale. " Sfera na paraqitet si prototype-i (mostra e parë), si njësi e të gjithë gjánave, e të gjithë formave. Asnji kând, asnji vijë, asnji sipërfaqe nuk tregohet në 'të, e me gjithë atë ajo i ka të gjitha pikat e të gjitha sipërfaqet .. Porsë përveç këtyne sfera ka maradhânje misterioze me gjánat e natyrshme; ajo na mëson përsosmin morale.

Më 1812 muer pjesë si vullnetar në fushatat e 1812-1813, për çlirimin e Gjermanis prej zgjedhës frënge bashkë me Lange-

thal e Middendorf, të cilët u bënë më vonë bashkëpuntorët e 'tij. Mbas mbarimit të luftës shkoi në Berlin tuj përshkue gjithë Gjermanin. Këtu muer një nënpunësi si ndihmës në muzeumin mineralogjik e pati kohë me studjue trajtat gjeometrike të kristalevet edhe u mendue përsëri për kuptimin e 'tyne simbolik. Dy vjetë më vonë, d. m. th. më 1816, vëndosi një herë e përgjithmonë me ia kushtue jetën e vet edukatës fëminore. Herën e parë zûni vënd në Griesheim, mandej në Keilhau (Gjermani), ku çeli një shkollë, qi e quejti "**Instituti i përgjishshëm Gjerman i Edukatës** „; në fillim të vetmit nxânës qenë të pesë nipat e 'tij. Këtu pati si bashkëpunëtorë Langethal e Middendorf. Në fillim instalimi qe mjaft modest, se i mungojshin të hollat, porse pak nga pak përparoi Instituti e më 1826 kishte më tepër se 50 nxânës. Këtu u zbatuen fare parimet e Pestalozzit. Në Keilhau edukata fizike, mëndore e morale shkojshin së bashku. Mësuesi duhej të përpiquej të kuptonte individualitetin e çdo nxânësi. Frœbeli ngeli për gjithë jetën e 'tij anëtar i nxëhtë i kishës Lutheriane, e gjithëherë ka mëndue se edukata duhet të jetë kryesisht fetare. " Çdo edukatë, qi nuk është e themelume mbi fën, është e pafrytshme „.

Këtu në Keilhau botoi më 1826 veprën kryesore "**Edukata e njeriut** „. Në këtë kohë ideja e kopshtit fëminuer edhe nuk ishte formue në shpirtin e 'tij. "**Edukata e njeriut** „, është më fort një shtjellim shumë i errët i parimevet të 'tija metafizike se sa paraqitja e zbatimevet praktike të metodës së Frœbelit. Hyrja është pjesa më interesante e veprës. Idetë qi përmban kjo veprë mundemi me i përmbledhë në tri pika, në tri idé të përgjithshme : n' atë të filosofis, të psikologjis e të pedagogjis.

Ideja e përgjithshme e filosofis është kjo : "Të gjitha vinë prej Perëndis. Në Perëndin është parimi i të gjitha sendevet „.

Ky është një pantheisëm, i cili qindron në të besuem se gjithë sendet e natyrës janë drejt për së drejti çfaqjet e veprimt hyjnuer.

" Qëllimi i çdo gjaje është me qitë jashtë vçtes së vet veprimin e Perëndis, qi vepron në 'të „.

Prej këtyne parafjalive Frœbeli shkon logjikisht në këtë pohim psikologjik qi çdo gjë është e mirë ke njeriu, sepse Zoti është ai qi v. pron në 'të,

* Përfundimin pedagogjik e gjëjmë fare lehtë: edukata do të jetë kryesisht një veprë lirije, vetishmije (spontaneiteti). Ajo duhet të jetë e butë, e përkulshme, e të kufizohet në të mbrojtunet e në të mbikëqyrurit. Fjalët **liri** e **vetishmi** përsriten shumë herë në veprën e 'tij. Frëbeli shkon deri mb' atë shkallë, sa që të thotë se nuk ka formë të përgjithëshme t'edukatës, që mund t' imponohet ose të porositet, sepse duhet të marrim para sysh natyrën e çdo fëmije tue vëzhgime zhvillimin e lirë t'individualetit, tue e grishë në veprim në veprën personale. Zgjedhja e të çfaqunit të mënyrës së përjashtme t'edukatës i dahet lënë inteligjencës s' edukatorit, e ai duhet me pasë aq mënyra të të rrituni individash, sa asish ka me natyra të ndryshme tue marrë para sysh gjithnji zhvillimin personal.

Frëbeli ka pasë një dashuni tepër të madhe për fëmijë, e ndoshta kjo është cilësia më e mirë e 'tij.

Mjetet edukatore mbas Frëbelit janë, veç fës, mësimet artistike, matematika, gjuha e mbi të gjitha natyra.

Instituti në Keilhau nuk lulzoi shumë kohë. Më 1825 u-ndeshit me e mbyllë nga mungesa e nxënësve. Frëbelit i murgojshin cilësit praktike t'administratorit. Më 1831 u-mundue më kot për me çelë një shkollë të re në Wartensee në Zvicër; kundërshtimet e partis së klerit e shtërnguen ta lënë më një anë. Mandej u-embue drejtor i njëj strehe vorfnore në Berthoude; këtu vendosi me i kushtue të gjitha përpjekjet e 'tija pedagogjike edukatës së fëminis.

Thonë se, tuj pamë një fëmi që po luate me top, i ra ndër mend ideja për kopshtin fëminuer. Dihet se sa rëndësi i epte trajtës sferike e lojës. I pari parim i **kopshtit fëminuer** të 'tij qe pra që fëmija të luate e të luate me top.

Frëbeli i paraqet fëmijës një numër gjânash, që do t' i shërbejnë si lëndë në ushtrimet e 'tij. Në planin e parë të Frëbelit ishin këto gjâna: topi, sfera e kubi; kubi i ndanë në tetë pjesa të njëjshme, kubi i damë në tetë paralelepipeda të drejtë, që paraqesin formën e tullavet, me anë të të cilavet do të ndërtojë fëmija. Ndërtimi porositet nxëhtsisht prej Frëbelit. Këtyne iu shtoi më vonë gjâna tjera, si dërrasëza, shkopij të vegjël për me ndërtoem fëtyra, copanletrash për me palosë, me bâmë pika në 'to, etj.

Ajo, qi përban meriten e veprës së Fröbelit, është organizimi i kopshtit fëmijues. Ai ka ditë me i futë në punë instinktet e fëmijës, me trajtue një sistem ushtrimesh për gjimnastikën e dorës, e për edukatën e ndijavet, me kënaqë nevojat e lëvizjes, e t'aktivitetit, qi zhvillohet qysh në ditën e parë të jetës; më në fund me e bëmë fëmijën një krijues, një artist. Me Fröbelin loja u-bà një element i qensishëm i edukatës; pedagogu gjenial ka ditë me e bëmë atë një art, një vegël të zhvillimit t' aftësive fëmijore.

Pra, sikurse kuptohet, lojrat e Fröbelit mbështeten mbi nevojat kryesore të fëmijës, d. m. th. mbi gëzimin, qi ka fëmija për të verejtun; mbi nevojën e aktivitetit e të pëlqimit qi ka për të ndërtue; më në fund mbi ndjenjën e personalitetit.

Idët e 'tij filluen me hymë në popull kah viti 1840. Shkollën e Blakenburgut e këtheu në një institut model tuj formue këtu kopshin e parë fëmijues. Nga mungesa financiare u-shtërngue ta mbylli më 1844 dhe shkoi përsëri në Keilhau; këtu çeli një kurs metodik për gocat, qi do të bäheshin mësuese. Më 1850 e çoi institutin e 'tij në kështjellën Marienthal; këtu i drejtonte ai vetë lojrat e fëmijve dhe formonte mësuese. Më 1852 vdiq këtu në moshën shtatdhjetë vjeçë.

Fröbeli ka pasë shum imitues. Sikurse Pestalozzi, edhe ky ka frymzue një numër të math shkrimesh; prej zellit të baroneshës Marenholtz dhe disa dishepujve të tjerë vepra praktike e 'tij lulzoi e u-përhap tepër. Kopshti fëmijues, me anën e të cilit e bëni emnin e vet të pavdekun, është i përhapun në gjithë botën e civilizueme, sidomos n' Amerikën e V., n' Austri e në Gjermani, natyrisht me disa ndryshime qi u-bënë mbasandëj, mbassi kishte mjaft të meta; por në thelp është po ajo gjë e ka po ato qëllime.

Përmbledhë prej

Jusuf Çekaj '32.

Karakterit e edukata kombëtare. —

Karakterit është kurorëzimi i edukatës dhe munt të themi së ky është pjella e 'saj. Po ç'është ky karakter?

Është një përmbledhje cilësirash të ndryshme që ka çdo njeri, e pas së cilavet çdo individ ka një **karakteristikë** të 'tij,

që e dallon nga invidiat e tjerë. Karakteri ndahet në **karakter të natyrshëm** e në **karakter të fituar**.

Karakter i natyrshëm është grumbulli i gjithë cilësirave, që trashëgon çdo njeri nga natyra. Ai i fituari është përmbledhja e cilësirave e e dhuratave, që fiton çdo njeri duke përmirësuar pakë a shumë dispozitat e natyrshëme nga rrethi ku rron e nga edukata që merr.

Karakter i fituar është përfundimi i edukatës; prandaj edukata duhet të kujdeset për këtë punë, dhe edukatori lipset t' i studijojë mirë e me kujdes të madh krijesat, që i janë besuar, pse karakteri, si thamë, nuk është i njënjëshëm në të gjithë njerëzit, e sidomos karakteri i natyrshëm. Çdo njeri, sikurse fiton nga natyra një pamje të veçantë, ashtu fiton edhe një karakter të veçantë. Kështu themi njeri me karakter të ftohët, të rrëmbyer, të ndieshëm, të pakujdesshëm, etj. dhe çdo njeri ka një mënyrë të veçantë të të menduari e të të dashuri.

E dukatori, që ka për të rritur kaqë karaktere të ndryshëm, duhet të përdorë një mënyrë edukatore të veçantë e të përshtaturë për secilin. Një karakter të butë nuk duhet ta trajtojë me ashpërsi, por me dashuri e duke i dhënë zëmër; përkudrazi një karakter i ashpër e i guximshëm duhet trajtuar edhe me pakë rreptësi, po pa e egërsuar e hidhëruar. Pra me anë t'edukatës, si njëri, ashtu dhe t'jetri karakter do të përmisohet, atje ku mundet, dhe kështu karakteri i natyrshëm do të këthehet në karakter të fituar.

Karakter i formon njerinë, njeriu formon kombin. Pra si karakteri i natyrshëm, ashtu edhe ai i fituari janë në marrëdhënie me edukatën kombëtare.

Karakter i natyrshëm vetëm ndërmjet individave, por ndryshon edhe ndërmjet kombeve. Le të hapim historinë e t'u hedhim një sy popujve të ndryshëm, do të gjëjmë në këta prirje të ndryshme e karaktere jo të njënjëshëm. Një popull është luftëtar, t'jetri paqësor e i dhënë pas bujqësisë e blegtorisë; njërit pakë i pëlqen bukuri e natyrës e e artit dhe është dhënë pas mendimeve të thella, pas shkencës sikurse populli gjerman. Disa janë tërhequr prej bukurisë dhe kërkojnë ta imitojnë e ta krijojnë këtë sikurse populli Italian e Grekit e vjetër.

Pra çdo popull duhet t'edukohet si pas prirjevet të 'tij, e për këtë punë duhet të përdoren methudha të ndryshme e të përshtatshme edukatore.

V. Nasto '30.

Pavarnija

Njeriu prej natyre është i pajisur me një shumicë instinktesh, të cilët ndënjë veprimin e shumë faktorve (të prindvet, t'edukatorit e të rrethanave) zhvillohen në drejtime të ndryshme.

Një nga këta është edhe **pavarnija**. Fillimet e kësaj na çfaqen qysh në vogëli, por koha në të cilën kjo merr zhvillimin më të madh, është ajo e djelmënis. Dëshira më e madhe dhe më me rëndësi në këtë moshë është të qenurit i pavarun. Në këtë kohë duem si e si të mund t'urdhënojmë vetë, të punojmë mbas dëshirës e vullnetit t'onë, pa uvarun prej ndonjanit, gjë që na sjell shpesh herë në pengime, pse liri veprimi të plotë ka vetëm në fushë të mendimeve e kurrë në atë të veprimeve.

Kjo dëshirë (me qenë i pavarun) është e drejtë dhe e dejë për një njeri. Por pavarnija e vërtetë është një gjë më tepër e mbrendëshme e nuk ka të bëjë aspak me lirin e jashtëme. Një njeri i varun prej një zyre, mundet me qenë më tepër më vehte, se sa një t'jetër, i cili mjaftohet me pasunin e 'tij në jetën e jashtëme, por që tërhiqet hundësh prej të tjerve.

I pavarun do të thotë mos me veprue kundër ndër-gjegjes s'onë, me punue si mbas një qëllimi të caktuem, që është i nevojshëm e i drejtë, e jo për dëshirë lafti e për frikë se mos qeshemi a damtohemi prej të tjerve. Një njeri është gjithmonë i pavarun, në qoftë se qindron besnik i ndërgjegjës së 'tij.

Shumë vetë kanë një mendim të shtrembët për këtë instinkt. Ata besojnë se bëjnë një hap kundërt k'ij, kur pijnë cingaren a gotën e parë. Por a është një gjë e vështirë për një të ri me pimë një cingare, kurse të gjithë e pijnë e kurse besohet se të qitunjt t'ym nga goja është një shejë dalluese e moshës burimore ? Një shejë pavarnije do të jetë vetëm atëhere kur të bëjmë të përkundërtën. Shumë të tjerë duen me e tregue pavarnin tue imitue zakonet e qejfet më të fëlliqta. Këta, sado që të shumën

e herës e shofin të paarsyeshëm të dhanunit mbas këtyne, nuk guxojnë me e ndalun vehten, ose nga frika e të tallunave, ose pse mendojnë se qejfet i përkasin, si duen të thonë, moshës burrnore.

Dëshirën për pavarni e kanë edhe vajzat. Nji vajzë ia ka mbërrimë ktij qëllimi, kur mund kotësin e 'saj, e cila nuk është t'jetër veçse nji të varun prej të tjerve. Në kësi rastesh nuk rrohet më për vehte, por për syt e botës. Ky është nji shkak qi shum njerëz nuk kanë nji veprim të lirë në punë të 'tyne e në çdo lëvizje gjajnë sikur tërhekin zvarrë ndonji palë pranga të padukëshme, nga qi nuk mund të bëjnë as punën më të vogël, pa u vu re fjalvet. Ja nji zakon i keq i përhapun mjaft nder ne. Sa marrri e madhe është me i vu vesh fjalvet të botës. e cila nuk merret me t'jetër, veç se me thënë-e-thashat e të tjerve. Në nji veprim, tue pasun ndërgjegjen të pastër e tue ditë se të sjellunin t'onë është mbrenda megjëve t'urtis, tue mos çënuë interesat e kërkuj, fjalët e botës duhen lënë mbë nj'anë. Qe nji parim më me rëndësi, i cili duhet të ngulet në shpirtin e çdo të riu.

Por në mesin t'onë gjinden shpesh herë disa, të cilët për çdo gjë, qi thonë të tjerët, tundin kryet në shejë moskënaqesije. Nga nji herë kjo vjen, ose pse ata besojnë se kanë nji mendim më të mirë, të cilit nuk duen me i uashmangë, ose pse mendimi vjen prej të tjerve e jo prej 'tyne. Asht nji sikur këta të thoshin : "Duem me qenë të pavarun, mbassi kemi nji dëshirë e vullnet t'onin e nuk jemi si disa, qi pranojnë çdo mendim .. Të vepruemit në këtë mënyrë nuk rrëfen t'jetër veç se nji koktrashësi.

Por a duhet nji njeri i pavarun me pranue mendime të të tjerve? Po, duhet me i pranue, në qoftë se të përlunin nuk është nji rrjedhje frike ase i nji dëshirë të dobët imituese, por përfundimi i nji të menduemi t'arsyeshëm e të përsijatuni të mirë.

Në qoftë se do të hudhim syt rreth nesh, do të shofim se njerës të pavarun me kuptimin e vërtetë të fjalës janë fare të pakë. Shum vetve iu pëlqen ma tepër nji pavarni e jashtme, e cila është me të vërtetë e pëlqyeshme; por është shumë më me rëndësi me pasun nji zemër të pastër e të mirë, kur të tjerët nuk e kanë; me qëndrue i ndershëm e besnik, kur të tjerët bëjnë të përkundertën. Njikjo duhet të jetë baza e jetës s'onë.

Mësuesi edhe në këtë rasë duhet me pasë kujdes që ndjenjën e vetvetes, që ka fëmija, mos me e shtypë, por ta përçojë nëpër një udhë të drejtë. " Duhet ta dijë fëmija me ndërgjegje se ajo që i jep vlerë njeriut, nuk është një gjë e jashtëme, as të përnjoftunit prej të tjerëve, as pëlqimi i huej, as lavdimi i huej, por vetëm e vetëm mendimet e ndjenjat edhe karakteri. (Börner)

N. Ndria '32.

Ndjenjat esthetike.

Natyrë e ndjenjës esthetike ka qenë objekti i bisedimeve të ndryshme : Të gjithë pajtohen në pikën se kjo ndjenjë rrjeth prej pëlqimit të marrun nga të bukrit; por çfarë është të bukrit e për çfarë pëlqimi është puna ?

Pëlqimi i të bukrit rrjeth prej njëj pajtimi ndërmjet njëj veprë të realizueme, të natyrshme ose mjeshtarake, edhe njëj ideal po t'asaj veprë të kuptueme prej shpirtit të njeriut. Ky element hyn po thuej në të gjitha teoritë e ndryshme të dhënuna për ndjenjën e të bukrit.

Njeriu do të thotë për një kal të vërtetë ose të pikturuem: " Ky është një kal i bukur ", sepse do të shofë të qitun përjashta fare qartas idën, që kishte pasë formue për një kal. Porse në ndjenjen esthetike ka një anë afektive : jo vetëm një kal i bukur i përgjigjet plotsisht idës së njëj kali, porse ideja e imë shkelqen aty me një shkëlqim të veçantë, që zgjon në shpirt një mbresë gëzimi, **kënaqsin esthetike**. Ndjenja esthetike nuk është pra vetëm një shkencë e aftësisë së njëj artisti, të plotnis së njëj pikturë; ajo është dishka më tepër se mbresa e këndëshme ose e pakëndëshme e shkaktueme prej njëj pamjeje të natyrës, të njëj fëtyrë, të njëj simfonie muzikore. Ajo kërkon hetimin ose përkuptimin e objektit, të cilit i kuptojmë të bukrit; ajo është e shqueme prej njëj mbrese subjektive, që është si e çfaqun përmbi gjasendin. Pa vërejtun, në qoftë se këto elemente përbajnë ose jo të qenmen e ndjenjës së të bukrit, kur do t'i takojmë ke një fëmijë përpara njëj pamjeje t'artit ose të natyrës, do të themi që ai e ka deri më një farë shkalle këtë ndjenjë.

Ndjenja esthetike kërkon **të vûmit në veprim të njëj numri të math funksionesh psikologjike**. Për me dhënë.

fjala vjen, nji gjykim përmbi bukurin e nji pikturë, duhet me dritë me vërejtun, duhet edhe me pasë kujtesë, imagjination krijues, nji shkallë afektiviteti të vetëdijëshëm. Porse duhet qi edhe funksionet t'ia kanë mbërrimë nji zhvillimi mjaft të naltë.

J Çekaj '32.

Vorfënia e jonë letrare

Kemi vorfëni letrare ?!

Po, kemi me të vërtetë vorfëni letrare, se na mungojnë libra shkollorë, romanca, novela, drama përshkrime dhe studime të ndryshme krejt origjinale. Rrallë, fort rrallë shofim aty, këtu nji botim të vogël, nji libër mikroskopik origjinal; shum rrallë lexuesi shqiptar shijon ndonji novelë shqipe, por nuk ka pamun fare këto vitet e fundit ndonji romancë. (Ah, Foqio Postoli, ku je, qitli jipshe letërsis shqipe edhe nja dy, tri romanca, tërheqëse?!)

Nëpër fletoret kombëtare (të na ndiejnë se po i zëmë në gojë) gjithnji po shofim si nënflutë të fletores të shkrueme këto fjalë: "Letratyrë Frange ose Ruse, etj. . . .", edhe na ka marrë malli të shofim të shkrueme aty fjalët: "Letratyrë Shqipe, . . .". Ku janë novelistët shqiptarë?!

Mos nuk ndjen aspak zemra e ndonjij novelisti të ai shqiptar, nga shkaku se Shqipnis i kanë bymë drehtikat (nazet) evropjane (!!), qi na i kanë përziem zakonet t'ona të shejta, a po mos nuk frymëzohet fantazia e tij nga malet, nga fushat, nga shqembet, nga lliqejt, nga vashat dhe nga bukurit e tjera natyrore të tokavet të Skënderbeut dhe i pëlqen të jetojë në monotonin shekullorë?

Asht e vërtetë se këto bukuri natyrore nuk kanë frymëzuem novelistë dhe romancierë, por kanë rritun poetë, si De Rada, qi këndon me "Mifosaon", dashurin dhe hakmarrjen e Shqiptarit edhe qi naltëson deri në qiell krijeshnikët kombëtarë, si Frashërin, qi tregon e bekon me "Bagëti e Bujqësi", jetën e bujkut, të bariut dhe të katundarit t'onë; si Frishtën qi këndon me "Lahutën e malcis", zakonet, karakterin dhe trimnin e të parëvev t'onë; si Prendushin, poetin optimist, qi këndon me delikatesë dhe me përmallime shpresën e njeriut; si Sqiro-in qi na mëson me "Milin e Hajdhin", dashurin e thjeshtë, por të përzemërtë, dhe

vajin e Shqiptarkës; si Lasgushin e ri, qi shprehi dashurin engjëllore të të rijvet; etj.... Me gjithë këtë vendi i ynë poetik mund të pjelli edhe romancierë, në qoftë se ata, qi janë të zotët e pendës, shtyhen për me shkruem... Por nuk mjafton vetëm dëshira, se duhet edhe dhurata e natyrshme....; e atëhere, kur do të lindet shkrimtari i ynë me zâ, lexuesi shqiptar ndoshta ka me shijuem ndonji romancë me stil dhe me mbrendi krejt shqiptare; aty ka me gjetun me hollësi zakonet e malsorit t'onë— e Shqiptarit-fejesat, martesat, gëzimet, vajtimet, nderin, besën, bujarin dhe mirëpritjen e popullit t'onë. Atëhere Shqiptari i mërguem, tue lexue romancat origjinale të shkrimtarit t'onë me zâ, do të kujtojë sikur gjindet në mes të prindëvet, të vllazënvet, të shokëvet e të miqvet të 'tij; do të kujtojë sikur po merr pjesë nëpër dasmat, sikur po fluturon andej, këndej nëpër bjeshkat me Zëpat Shqiptare, etj edhe me lotë plot mallëngjim ka me vajtuem fatin e zi, i cili kusli e din pse, e ka bâmë me u-larguem prej vofrës së 'tij stërgjyshore Por ta lëmë kohën t'onë t'ardhëshme! se Shqiptari është i sigurtë qi dikur, shpejt a vonë, natyra e jonë, qi na ka dhânë Omerë, do të na falë edhe ndonji Dumas a Manzoni; prandaj le të mëndojmë për djersën e etënvet t'onë të shdukun.

A i kemi ato vepra, qi kemi pasun?

Na duket se jo.

Na ka marrë malli qi të shijojmë "**Milosaon**," dhe "**Serafima Topja**," të De Radës, "**Milin e Hajdhin**," të Sqiro-it, ndonji vjershë të bukur të Çajupit, poetit melankolik, etj, po ku t' i gjejmë?

Kemi uni pra për veprat, qi na i kanë lânë të parët t'onë. Për fat të keq librat e shkrimtarëve t'onë të parë pak nga pak po na shduken prej duervet t'ona dhe shum prej atyneve kanë fluturue fare nga rafti i librëshitësit shqiptar e në këtë mënyrë errësohen edhe kujtimet e auktorëve. Asht e vërtetë se fantazia e popullit e ngren nalt emnin e nji njeriut të vjefshëm, por vetëm kur jetojnë veprat e 'tij.

Muza popullore këndon kurdoherë kreshnikun, trin in, viganin, por nuk zen në gojë fare shkrimtarin, e atëhere qysh ka me mbetur i pa vdekun kujtimi i 'tij? Kujtojmë se mbetet vetëm me veprat qi len mbas. Prandaj nuk duhet të mjaftohemi me bo imin e njihertë të veprave, se mbarohet qarkullimi i 'tyne

dhe bashkë me këtë humbasin edhe mendimet me stilin e këndëshëm, edhe më në fund ndoshta shuhet emni i auktorit si njeri i ditun nga fjalori menduer i popullit. P. sh. ndoshta tashti rinija shqiptare ka ndigjue se nga Shqiptarët e Italis ka lulëzue dikur një poet, një fillosof, një shkrimtar, një prijsi i liris kombëtare, Girolamo De Rada, po mbesoj se asnjë s'ka lexue ndonji vepër të De Radës, se sot shkrimet e 'tij nuk gjinden më te librëshitësi shqiptar e dhe biblioteka (për veç Tiranës) nuk kemi; prandaj të rrijt e kujtojnë De Radën si njeri të dijtun jo se i kanë studijue veprat, por pse e kanë ndigjue prej të tjerëve. Mbas tridhetë vjetve pra qendron kaq i errët kujtimi i këtij poeti në mendjen e rinis s'onë; le të mendojmë tashti se, në qoftë se nuk shtypen përsëri veprat e 'tij, qysh ka me mbetun ai kujtim mbas një shekulli? S'ka dyshim se kujtimi ka me u-errësue fare. Prandaj për këtë kohë duhet të mendohe mi, për këtë kohë duhet të punojmë. Ne, stërgjyshënit e breznive t'ardhme, sot duhet të ngrëfim biblioteka, sot duhet t' i shtypin veprat e rrallueme; sot duhet të mbjellim farë jo të kalbun, por të mirë, qi të mund të korrin dishka stërnipënit t'onë dhe të lëmë të 'tilla kujtime, qi breznit e ardhëshme t' i kujtojnë me përunjësi gjatë shum shekujve emnat e etënve të shdukun dhe me përmallime të gjunjëzohen përpara kujtimeve të paharrueme të burrave me mend të Shqipnis.

Por, për me sigurue një nder të 'tillë, duhet, sikurse thâmë, të botohet prapë çdo vepër, qi i ka mbarue shtypja e pare ose e dytë (sa për shkrimet e reja, qi kemi nevojë, le të mendojnë shkrimtarët e sotshëm). Mandej duhet të ngrifet në çdo qytet nga një bibliotekë, ku të ruhen gjithë thesaret e letërsis s'onë.

Mirpo të gjitha librat nuk është e mundun t' i botojë shteti, prandaj, sikurse e ka thënë dikur fletorja " Ora, „ duhet të themelohet një shtëpi botonjëse. Për veç kësaj do t' i baje një shërbim të math letërsis s'onë ai njeri, qi do të botojë jetëshkrimet e shkrimtarëve t'onë; ose më në fund nuk do të bëshesh keq qi të përkëthehesh shqip prej auktorit vetë vepra, e shkrueme në gjuhën Italishte, "Popolo lingua e letteratura albanese, „ se kështu, edhe në qoftë se nuk i kemi shkrimet e shkrimtarëve, së paku do t' i dijmë se cilët janë. Sa për ngrëfjen e bibliotekave u-mbetet barra më tepër bamirësve shqiptarë.

Sot për sot duhet t'u jemi mirënjohës Franceskanvet të shkodrës për të botuemit përsëri të veprave, të thuesh të harrueme (si Bozuku, Bogdani, Budi, Matranga, etj), qi janë thesare të çmueshëm të gjuhës s'onë.

St Spasse '32

Provë mësimi.

dhânun në klasë të IV-të të shkollës Ushtrimore.

Landa : kallzime morale.

Thema : Dy plugjet.

Ata kanë mësuem më para metalet, e nashti u thohet të dëftejnë se cilët nga këto janë më të çmueshëmit e cilët janë ata, qi s'janë të çmueshëm, por qi janë shumë të vjefshëm. Natyrisht do të vijë puna ke hekuri, i cili me të vërtetë s'është i çmueshëm sa ari e argjandi, po qi hyn në punë për të bëmë gjithfarë veglash, të cilat s'mund të bëhen me t'jetër gjã veçse me këtë metal. Do t'u thohet se çfarë veglash bëhen me hekurin, e mbasandaj do t'i çojë të thonë edhe plugun, të cilin e kap nga goja e nxënësvet, dhe zë e u thotë : Po a dini ju se si u ngajti një herë dy plugjeve ? Nx. Ndigjoni pra t'jua tregoj unë : "Nji bujk kishte dy plugje; njani nga këta e donte fort punën, e t'jetrit i pëlqente të rrinte gjithnji me dier lidhun. Ky plugu përtac gjithnji e mërziste plugun punëtuer tue i thânun : „ Sa i mjerë qi je ti ! ç'të duhet ty të dalish e të ngreish për-pjetë gjithë ata plisa të randë ? Nuk më shef një herë mue, qi s'punoj, sa i frytë e i shëndoshë jam ? Oh, sa budalla qi qenke, ore ! Të dal unë atje e të loth vehten t'eme kot fare ! Eja të rrijmë këtu bashkë e të fjalosemi, se do ta shofish sa i lumtun ke me qenë „ Po ai, qi e donte punën me shpirtin, s'i bëzante fare.

Nji ditë kishte punuem shumë e në mbrâmje e ndiente vehten të lodhun pak dhe po rrinte si varë. Përtaci, tue e pamë kështu, i flet me një të math : "Ore, po unë plasa me ty ! Ty s' t'u-mbushka n'endja. Hiq dorë nga puna, të them, se do të hekish keq.„ Puntori i u-këthye edhe i tha : " Ti i paske syt mbyllë ! Nuk e shef vehten t'ate se si je bëmë ? Ti je nximë e je bëmë si bloza, je kalbun fare, e po të bije trupi tej copa, copa; kurse unë, qi i përvishem punës me dëshirë e me vullnet,

shkëlqej si argjandi e e kam trupin fare të mirë.

— Mësuesi bën në dërrasë të zezë plugun puntuer e atë përtac tue e parafytyruem të parin me fytyrë të vrantë e me duer e kambë të varëme, si edhe të dytin të trashë, me një palë musteqe të mëdhoja e me disa copa të hjekme nga trupi prej ndryshkut.

— Prej meje im zot shef një dorë fitim, po prej teje, or i mjerë, çfarë do të shofi, veç se i ke zënë vendin kot? Tue biseduem këta të dy, shpëtoi një ka edhe zë e po endesh nëpër burg. Qëlloi qi shkoi aty afër plugut përtac e e shkeli. Këtij i u-shtyp fare trupi; mirpo, kur vojt e shkeli plugun-puntuer, qi shkëlqente e ndiste gjithë burgun, ky s'ie ndjeu fare thundrën e atij kau të randë. Atëhere i u-kthye përtacit e i thia: "A e kuptove nashit se sa hilaç shërimtar e i mirë është puna?," Kërrusi kokën e s'foli fare. Si të jetë përsëritur kallzimi prej nxënësve, (pjesë pjesë prej shumicës dhe e tanë prej një a dy nxënësve), bëhet një pyetje e përgjithshme tue u thënë se këjo është një përrallë, po ç'na mëson neve këjo. Pastaj u thotë se çfarë njeriu mund të vënë në vend të plugut përtac e çfarë njeriu në vendin e plugut puntuer. P. sh. marrim dy gjindarmë, njëni e kryen punën, qi i është ngarkuem, me ndërgjegje, e tjetri i dredhën punës. Ai qi e bën me ndërgjegje, rrin i qetë, por ai tjetri rri gjithnji me tristim, se mos e hekin. Veç kësaj i pari është i kënaqun, edhe bofa e duen e e nderojnë; pra puna të naltëson. Ai qi s'punon, merret gjithnji nëpër kambë; po ai qi punon, ka edhe një të mirë, se puna ia mban trupin gjithnji të shëndoshë.

Ne kemi edhe një fjalë të urtë, qi na thotë: **mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë**. Po të jetë trupi i mirë, atëhere ne jemi të qetë, se nuk kemi ndonji dhimbje, e kështu edhe mendja e bën punën e vet pa të metë e të sigurtë; po, kur e kemi trupin të sëmundë, mendja nuk është e zoja më ta bëjë punën e vet, se ne atëhere kemi hallin e dhimbjes. Po ju mos kujtoni se trupi i shëndoshë është ai i frytë, se ky është nga hera i kalbët si ai i plugut përtac. Ai qi punon, nga një herë mbetet thatiq nga puna e randë; porse është i fortë. Me gjithë atë ka edhe njerës, qi punojnë e janë të frytë; këta e kanë trupin të mirë.

Ne kemi edhe ca fjalë t'urta, qi flasin për puntorin e për përtacin: Kush s'punon, dëmton; kush punon, fiton; ai qi s'ka

punë, luen derën, etj.

Po edhe shumë e pa masë s'duhet të punojmë, se sëmuhemi. Sikurse u muerën gjindarmët, merren edhe dy nxënës, një puntuer e një përfaq; ç'përfundime ka i pari, ç'përfundime ka i dyti, si në pikpamje të moralit, ashtu edhe të fitimit e të dobis. Veç këtyneve mësuesi u thotë se njetëzit e njëj shteti duhen mirë e shkojnë njani me tjetrin, kur ata punojnë të gjithë me ndër-gjegje e me vullnet. Atëherë ata nuk e përbuzin njani t'jetrin më, po përkundrazi flasin mirë e punojnë së bashku. Po ashtu edhe një e mirë t'jetrë, e cila i vjen shtetit nga puna, pse, sa më puntorë të jemi, aqë më tepër fitim do të ketë e aqë më tepër i fortë do të jetë.

I Shishmani 132.

Provë mësimi

Dhënë për stazh në klasën e 11të të shkollës
Ushtrimore.

Thema: Mësim jetë

Landa: Të lintat t'ona dhe dita e të larit të rrobeve

Shtjellim

Sikurse dihet, çdo njësi methudhike munt të fillojë me gjithfarë paragatitjesh, por kujdesi më i parë i mësonjësit duhet të jetë që të zgjedhi një t'afillë, që mund të zgjojë kureshtën e nxënësve dhe të munti t'afrojë parafytyrimet e para, të cilat do të ndihmojnë në përvehtësimin e parafytimeve të reja. Pra si paragatitje për këtë mësim përdoret rrobeqepësi, që ashtu bërë disa ditë më parë.

Së këndejmi fillon mësimi i ri:

Përflitet shumë a pak mbi punën e rrobeqepësit: ai na pret rrobat e sipërme, të cilat quhen kështu, pse vishen sipër, dhe nga këto hyjnë në rrobat e mbrendëshme ose të lintat e ndryshme: brekë, këmbishë, fanellë, mintan, linjë, jelek, xhamadan, etj; dhe, mbassi të nguliten këto duke i folur dhe horas, përflitet lënda me se bëhen këto (beze, hase, cipë e mëndafshetë, etj); ku i marrim këto (në treg dhe në shtëpi); mënyra e të bërit dhe kush na i bën duke shkuar fantastikisht si mbas mënyrës së veprimit në jetë. Në këtë mënyrë pra mbaron zhvillimi i pjesës së parë të kësaj njësie methudhike.

Mbasi të kuptohen mirë ç'u thënë më lartë, fillon pjesa e dytë, dita e të larit rrobe, në këtë mënyrë: Të lintat e reja që premë, nukë i mbajmë shumë kohë veshur; kallzohet se mbas pak ditësh (zakonisht një javë) i nxjerrim për të larë, se na janë bërë trokë dhe na janë ndyrë. Dita e të larit, vendimi i marrë dy, tri ditë më parë a të paktën një ditë për të larë rrobet, nëna porosit babën të bjeri sapun dhe dru; përgatitjet e tjera, të provizionuarit e ujt më të mirë, ujë çesme, vije, shiu dhe lumi duke tregue arsyet; ndërrimi i teshave të palara dhe veshja e të larave në mbramje a në mëngjes; kush i ndërrohen fëmijet e vegjël; porositen që të mos qajnë, kur ndërrohen, mbassi shumë fëmijë sillen kështu.

Gdhin dita e të larit, nëna a puntorja ngrihet heret në mëngjes: ndes zjarrin, vë këmjet dhe përmbi këto kazanin a kusin e madhe; bën finjën me hi të pastër të marrë nga furr-xhiu, ngreh koritën dhe, kur sheh se u-bë finja, fillon punën duke përveshur krahët. Gjithë teshat i fërkon katër herë me sapun dhe me ujë të nxehtë dhe mandej në kazanin e pastruar, grin pak sapun dhe i vë në zjarr, që t'i ziejë teshat e fërkuara që thamë më lart; si të ziejnë mirë, i nxjerr me një shkop, i heth prapë në koritë, ku i fërkon edhe një herë a dy herë të tjera dhe mandej, mbassi ti këtë shtrydhë mirë, i ndër në litar a në tel të pastruar, që të thahen. Flitet për të terurit e teshave (vera dhe koha me erë është më e posaçme për këtë punë), të mbledhurit, të prurit në shtëpi, t' andruarit, të rrahurit me hekur palosja dhe të vendosurit e tyre në sandëk.

Gjithë këto punë bëhen, sa të jetë e mundur intuitive me sendet e ndryhme të prura në klasë dhe duke u-ndjekur veprimi i natyrshëm i kësaj pune në jetë.

Si përmbledhje përsëriten shkurt pikat më të rëndësishme duke treguar vetë nxënësit gjithë punët e sipërme dhe si ushtrim theksohet mundimi i nënës ditën, që lanë rrobet, shpenzimi i prindit për dru e sapun, shëndeti në rrobet e pastërta, prandaj është e nevojshme mbajtja e këtyne pastër dhe kujdesi për to. Me kallzimin e punës, që u-bë në këtë orë, merr fund ky mësim.

Mjete mësimi.

Koritë, një këmishë, një palë brokë, një linjë, një mintan, sapun, çivit dhe një palë tasha të lara të rafme; basme, beze, hase, etj.

M. Golemi '29.

Provë mësimi

Dhânë në rendin e I t' Ushtrimores

Landa: Mësim jete

Thema: a) Kopshtari e punët e tij

b) Mbledhje e zbritje me katër numra.

a) **Hyrja.** Ku i mbjellim lulet ne? Nx: Lulet i mbjellim në fushë e në kopsht. Po t'jetër gjë çfarë mbjellim në kopsht? (Qepë, hudhra, lakna, lëpjetë, spinaqë, etj).

Paraqitja. Pra kopsht i thomi atij vendi, ku mbillen qepë, hudhra, lipjetë, etj. Kush di të më kallzojë se si është ai? (krahasohet me arat e me fushat). Nx: Kopshti është një vend i vogël, i rrethuem me telë, me garth ose me mur. Lihet një nxânës, që të flasi për kopshtin e shtëpis së vet. Kush di të më kallzojë se çfarë gjënash mbillen në kopsht? Nx: Në kopsht mbillen hudhra, qepë, prasë, lëpjetë, spinaqë, sallatë, damatje, magdanos, patllixhana, specia, kastraveca, etj.

Disa nga këto dalin në prandverë (hudhra, qepa, lëpjeta, spinaqi, sallata, magdanosi, etj); disa të tjera dalin në verë (domatja, patllixhani, specia, kastravec, etj).

Bâhet një krahasim ndërmjet zarzavatevet, që dalin në verë; p. sh. atyneve të pranverës u hahet trupi e gjethet (hudhra, qepa, lëpjeta, spinaqi, etj). Këto nuk bájne kokrra; përkundrazi atyneve të verës nuk u hahet trupi e gjethet, por vetëm kokrrat (domatja, patllixhani, specia, kastravec, etj).

Si iu thomi me një emën këtyneve, që mbillen në kopsht? (**Zarzavate**, ose perime).

Përse i mbjellim ne këto? Këtu iu flitet përse përdoren ato.

Të gjithë ne kemi kopsht në shtëpi? Nx: Jo. Po ata, që s' kanë kopsht, ku do t' i marrin zarzavate? (Në pazar). Si i thonë atij burri, që shef zarzavate? (Zarzavateshitës). Në çfarë vendi shiten këto? (Në Renët).

Si i thonë atij burri, që punon kopshtin? (**kopshtar**). Ne folëm se çfarë gjënash mbjellim në kopsht; kush e di se kur mbillen këto? (Në prandverë). Lihen nxânsit që të gjykojnë sepse nuk mbillen në dimën. Flitet shkurt se si mbillen zarzavate; kallzohet edhe se si punohet kopshti; p. sh. herënë

parë e plehënosim, pastaj e punojnë me qyrek a me bel, e coptojnë me kazëm, i bëjnë brazë me shat, etj. Farat i mbjellin me lehna e, mbassi bëjnë, i fusin në brazë a n'oxhakë.

Në brazë futen hudhrat, qepët, etj; n'oxhakë futen kastravecet etj. Të tjerat, si magdanosi, lëpjeta e spinaqi mbillen me të hudhme farë.

Flitet edhe për kujdesin, qi u duhet bëmë atyneve; p. sh. të capohen, të qërohen barishtat, t'ujiten, etj.

Përmbledhja e përdorimi. Mbassi të jetë folë gjënë e gjatë për kopshtarin e punët e tij, atëherë bëhet një përmbledhje e gjënavet kryesore: Kopshti është një vend, ku mbillen zarzavate; ai qi e punon këtë, quhet kopshtar. Në kopsht mbillen hudhra, qepë, prasë, lëpjetë, spinaqë, etj. Këto na hyjnë në punë për t'u ushqyem. Toka punohet mirë. Zarzavalet mbillen me lehna: këto mbillen disa në dimën, si sallata, lëpjeta, etj, e disa në pranverë, si qepa, domatja, kastravec, etj.

Më në fund këto thohen prej disa nxënësve, me qëllim qi me ua rranjosun më mirë në mendje, kështu qi t'u hyjnë në punë për jetën praktike.

b) Përmenden edhe një herë gjënat, qi bëhen në kopsht e këto përdoren si landë për me bëmë arithmetikë, me qi çdo landë mësimi duhet të dalë nga mësimi i jetës. Pra, u thohet nxënësve: Ditën e shtunë vojta në pazar e bleva 7 okë lëpjetë, një burr bleu 4 okë, një tjetër bleu 2 okë e një tjetër prapë bleu 1 okë; sa okë lëpjetë shiti zarzavateshiti? Nx: $7 - 4 - 2 - 1 = 14$ okë lëpjetë. Na këto do t'i shkruejmë (urdhnohen me nxjerrun radhoit e kalemat me numurim 1, 2, 3.). Ushtrimet tregohen edhe me gishta prej nxënësve; lihet një nxënës ta thotë ushtrimin, e të tjerët e shkruajnë nëpër radhoit. Mësuësi shkruen në dërrasë të zezë. Kështu bëhen edhe ushtrime të tjera: $8 - 6 - 5 - 1 = 20$ tufa sallata; $7 - 4 - 3 - 2 = 16$ tufa qepë; $9 - 3 - 2 - 1 = 15$ tufa hudhra; $6 - 5 - 4 - 3 = 18$ tufa prasë, etj.

Një zarzavateshitës nxuc në pazar 20 okë spinaqë, një herë shiti 7 okë, një herë 6 dhe një herë tjetër shiti 3 okë; edhe sa okë spinaqë i mbetën atij? Nx: $20 - 7 - 6 - 3 = 4$ okë. Kështu veprohet edhe për këto ushtrime: $18 - 8 - 4 - 1$

== 5 tufa qepë; 16 — 9 — 3 — 2 == 2 tufa hudhra; 13 — 5 — 2 — 1 == 5 tufa sallata; 10 — 4 — 2 — 1 == 3 okë lëpjetë, etj.

Tabella e mësimit

7 — 4 — 2 — 1 = 14

20 — 7 — 6 — 3 = 4

8 — 6 — 5 — 1 = 20

18 — 8 — 4 — 1 = 5

7 — 4 — 3 — 2 = 16

16 — 9 — 3 — 2 = 2

9 — 3 — 2 — 1 = 15

13 — 5 — 3 — 1 = 4

6 — 5 — 4 — 3 = 18

10 — 4 — 2 — 1 = 3

Q Skuqi '32.

Novelë

Ah, nënat....!

(për Koli Gushon)

Më të dalë të fshatit, në mest të njëj lëndine të pjerrët, gjindet Kisha e Vogël e Iyer me gëlqere. Po i afrohesha dalë nga dalë, pse udha i shkonte afër dhe e linte nga ana e sipërme, më të djathtë. Kur hynje nga dera, ngriheshin dy selvi të gjata, majat e të cilave përkuleshin nga veriu i hollë, që vinte nga gryka e malit. Disa zogj fluturonin lehtë dhe fshiheshin nëpër degat e shpeshta të selvive

E vetme, me kokë unjur përmbi një gur, rrinte një grua, e cila nxirrte një zë, që të përqethte mishtë. Qëndrova dhe po e shikonja. Vajtonte...! Ç'i ka vdekur asaj gruaje të shkretë?— pyeta një burrë të shkuar nga mosha, që m'u-afrua me hapa të ngandalshme me një shkop në dorë. Nuk u-përgjegj përnjiherësh; psherëtitë dhe po ecnim së bashku.

Dyke ecur, filloi të më tregojë :

Vajton, më tha, dritën e syve, birin e 'saj të vetëm, që e ka lënë të shkretë! Heshti për një copë herë, e unë thashë se nuk do të flasi më, porse ay filloi të më tregojë prapë jetën e gruas së mjerë e, nga fjalët që nxirrte, kuptonja se ndiente dhëmbsurë për të. U-bënë pesëmbëdhjetë vjetë, or zotni, që kurse i shoqi u-vra në luftë. Mbeti me këtë djalë të vogël, i vetmi ngushullim për të. ; ky dalë nga dalë po i rritesh, dhe gruaja po i harronte mjerimet e shkuara, pse një fildan i mbarë po ia mbushte shtëpinë.

Djali, si mbaroi shkollën e fshatit dhe atë të qytetit, që e kemi këtu afër, desh të vijonte edhe në ndonjë shkollë t'jetrë; i kishte hyrë në zemër shkolla, dhe mësimi i pëlqente më shumë se sa jeta e mjeshtria e këtij vëndit t'onë.

— Ndofta do të ketë qënë ndonjë mësonjës i fshatit, që ia kishte mbushur shpirtin me të këtilla ndjenja. Rrallë herë fshatarëvet u mbushet mëndja që të lënë mjeshtërinë e babës, e malet dhe ujët e ftoftë të krojeve, me të cilat janë rritur, dhe të shkojnë lark për të mësuar, sidomos kur qëllon të jetë i vetëm në shtëpi—thosha me vechten t'ime. E kishte vendosur të shkonte, po një pengesë ia priste hovin këtij djali. Qe e ëma, e cila, sa herë që i biri ia zinte në gojë largimin, qante dhe e pushtonte, se mos i ikte n'atë çastë. Ishin të kota fjalët e Kolos, se kështu e thërriste, për t'ia mbushur mëndjen asaj nëne të vetme. Më në fund e bëri zemrën gur e me gjysmë shpirti e përcolli duke i dhënë këshillat e 'saja.

Kaloi një vit i shkollës, e djali kur ardhni, ishte bërë më i math, më i bukur. Me radhë e përcolli dhe dy vjetët e tjerë e, kur ishte për të katërtin, në këtë vit të zi për t'ë, nuk e la të shkonte prapë. — Plaku u ndal dhe, kur e vështrova, po fshinte lotët me një shami të madhe, që e nxori nga brezi.

Ç'ke? e pyeta: Ah...! e kishja nip, m'u-përgjegji, dhe ajo që e qan, është motra e ime. — Ishte në kishë e, kur të gjithë njerzia iknë, ky mbeti më vonë, për të shkëputur të motrën nga varri, po më kot. Nukë foli më gjatë, se zemra e 'tij s'duronte dot të qitte t'atilla fjalë që e lëndonin, po me ngadalë shtoi se djali ishte i sëmurë; mjeku e këshilloi të rrinte simvjet në shtëpi, kur mbas tre muajve na e shkëputi Zoti nga gjiri i ynë.

Plaku ma kishte futur gjithë hidhërimin e 'tij me ato fjalë melankolike e, pa ditur se ç'ti them, kur u-ndava, mora udhën me këto mejtime, që ma kishin pushtuar shpirtin.

Nukë gëzohesh ti, o mëmë e dashurë, që unë të vete në shkollë e të bëhem më i mirë, më i ditur se sa jam e mbas pesë vjetve të dal me një zana, ja, si ky i mësonjësit t'onë; nukë të pëlqen a...? Kështu i thosh i biri për t'ia mbushur mëndjen s'ëmës, që ta liate të vijonte shkollën.

101 I kujtohen zotimet, që i kish dhënë Kolua se, mbassi të mbaronte, do ta mirte pas, kudo që do ta hidhnin në kohën e verës. Tashi i doli nga fjala! Nukë ndëgjjon, kur ia thotë e ëma, përmbi varr: **A s' më merr me vehte? s' të dhimbem...**? Ndofta i ruan për më vonë. Ka shpresë; edhe s' janë mbushur pesë vjetë, është i katërti. Kjo e mban me shpresë dhe i lutët ngahera mbi varr, që të mos harrojë mbas pesë vjetve, se s' i rrihet vetëm; këtë ia kishte thënë që vitin e parë.

102 Si do të durojë pa Kolon përgjithënjë ajo nënë, që s'donte ta largonte as për një vit? Duron, duron se ja edhe dy muaj e vjen ajo ditë, kur Kolua me një valixhe e me një arkë violine në dorë, vinte pa pritur ne dera e shtëpisë. Kështu i shkon mëndja shumë herë dhe i harron të gjitha.

103 Gjithënjë pret se mos i vijë ndonjë letrë e më shumë, kur afrohet ndonjë ditë feste; se kështu e kish zakon t' i dërgonte kartolinë për urim. Ditët e muajtë shkojnë, po Kolua i zëmrsë, s'e kujton. E priste; iku muaji i Qershorit, po ay s'u duk! Vajti në vreshtë, mori disa dega me qershi të kuqe dhe ia shpuri në varr. Ato qershi, që ia ruante për mot, kur vinte në verë nga shkolla, simvjet atje, përmbi gurët e ftohtë, ia kishte shpurë t' i hajë, po ay s'desh ti mirte.

104 Simvjet nukë i shkrojti s'ëmës, që t'ia ruante ato degat më të larta me qershi të kuqe! Sof ato ia qarkojnë gurin e varrit! s' i merr qershitë, se ato janë me gjethe të vyshkura. Ay shkon vetë si një zok në degat e larta, ashtu si bente ngahera. Lulet, që i kishte shumë qejf dhe i mbillte vetë në kopësht, u-thanë, se s'ka kush t' i ujiti! Ay s' do t' i marri, kur ia shpie e ëma në varr; edhe këto nukë i do të këputura, po shkon vetë dhe u merr erë si një flutër.

105 Kolua nukë dëgjjon t' ia marri një herë me violinë asaj këngës së gëzuar dhe ta kënaqi t' i mën ashtu si përhera. Ngrihet natën fshehurazi dhe ia merr një t'jatrës, që s'e ka dëgjuar ndonjë herë e ëma! Jo me atë këngë, që të zgjon nga gjumi, po një t'jatrë... që të ve në gjumë! I çel sytë me kujdes se mos e shohi, mirpo ay e ndien e ikën me të shpejtë! Ngrihet e shkreta si një e tërbuar, po asgjë nukë sheh, veçse ndigjon tingullimin e telave, që edhe s' kanë pushuar së dredhurj. E puth vëndin, ku Kolua mbështette faqen, dhe bie prap pa mënt.

Simvjet Kolua vonoi të shkojë në shkollë, se ja rrobet të gjitha i ka të përndara nëpër shtëpi. Ato njihen se e kanë të shkruar me pë të kuq numrin (78). Aty nëpër dallap i ka dhe librat, pendën, ngjyrën e fletët me nota të muzikës; disa kartolina të bukura, që ia kanë dërguar shokët, i ka varur në dhomë...

Të ftohtit sa vinte po shtohet. Dëborë kishte zbardhur majat e maleve dhe po zbriste dalë nga dalë edhe në fshat. Çatitë ishin ngarkuar rëndë në dëborë dhe trarët kërcisnin nëpër shtëpitë e vjetra. Veriu frynte më të katër anët dyke vëshëllyer nëpër të çarat e mureve. Njerzia visheshin trashë.

Sot Koli ishte ngritur shpejt, që larë e po vishte pallton e madhe. Pse je ngritur kaqë shpejt? e pyeti e ëma. Po nuk e di, o nënë, se sot kemi ditën e emrit t'im? Ngreu dhe ti, se do të shkojmë në kishë; kambana po bije; pastaj të vijmë shpejt, që të përgatitim dhomën për të pritur miqtë. Kështu e pa në ëndërr, nëna e giorë, natën që gëdhinte dita e emrit, gjashtë Dhjetor — Natën e 14 Dhjetorit e pa prapë Kolon buz-qeshur, që i thosh: "Nëno, nesër i mbush plot shtatëmbëdhjetë vjetë e hyp për të tetëmbëdhjetin; u-bëra burrë... " Kështu e lëndonte zemrën e s'ëmës duke përsëritur ato fjalë, që ia kishte thënë natën e fundit, një mot më përpara.....

T. Gusho '31, m. 2

Atje ku dirgjen dëshmorët.

Kur të kthehesh i lodhun prej ndonjij rruge të gjatë, a kur të të bjerë puna të kaloish brinj pyjeve të blierueme, ndal-u një herë pranë burimit të Doçit, (1) pranë atij vendik u lëshuen t' of-shame, kujtuen nënë e fëmi e dhanë shpirt aqë e aqë burra, e aty flladit mushkënit a fëtyrën me akull. Shiko atëhere për-qark e, në pafsh ndonji bulë uji, qi rrjedh me dhimbë prej lëkurës së çame të drunit, a ndonji lule me krye të përkulun prej pikës së voesës, qi s'e ka shkrimë mirë dielli, le të të kuj jtohen lodët, qi u-derdhën për ata fatosa, të cilët e shtrydhën në grusht vdekjen. Jij zemërgur atëhere, në dash mos me i njomë syt. Ven veshin pranë burimit e, kur të ndiejsh atë të gurgullisun, mos u-mallgje më tepër, se sa kur qan nëna birin e vetëm, Shtriju mandej në blerimin, qi ke pranë të stolisun

me gjithë bukurit, por shikjo mos shtypish ndonji mizë dheu a t'jetër insekt, të rritun e t'ushyem ndofta me atë gjak qi aty u-derdh, e atëhere verej kah qielli e, në mos pafsh t'jetër, ka me t'i mbyllë syt një fëllim i shpejtë, por plot ambëlësim, qi zbrit prej majës së lisave tue kumbue si nj'ai tel' i prekun me të lehtë prej dorës së prarueme. e mandej, kur ke me tretë në një gjum të thellë e të mallshëm, ke me pamë, kush e di, sa ándrra të kándëshme, ku ka me t'u-kënaqë shpirti, e do të piques me nj'ata qi aty prájne. Ndigjo atëhere si dridhet ajri e si ushtojnë pyjet prej melodis së mrekullueshme e, kur të të japin dorën, thuej-u : " Ju lumtë... Vere-i në fytyrë se sa gëzueshëm e shkojnë motin e shiko-i se si me madhni enden ndër lule, ku vall-zojnë bylbylat e ku me të lehtë filladi palos fletët e trandafilit. Një oshtimë e thekshme mandej ka me ta nxjerrë gjumin e, kur të jeshë tue hapë syt nëpër mes të njëj erës së rrëmbyeshme ke me ndigjue : " për atdhë, për atdhë „; ke me u-zgjuem atëhere me të shpejtë, por s'ke me pamë t'jetër veç vetmin e pyllit e ndofta nalt, nalt në qiell ndonji ré të bardhë, qi lan vendin pa prà. Mos u-habit. Hec mà poshtë e atje pranë pro-it, të cilin tash ke me e gjetun të qetë e si të fjetun, atje ku fijet e barit e lulet janë me krye për toke, le të të ngjallen aqë vraga në zemër tue të përshkue dhe rrymat mà të rrëmbyeshme të gjakut e siell ndër mend atë ujë dikur në gjyrë të kuqe e ata vende në gëzim. Shiko aty pranë e ke me pamë plot truma gurësh afër njána, t'jetrës; nj'ata janë vorret e dëshmorëve; aty prájne sa shpirtna të kthjellët. Hidh-u dhe ti nga një gur e basnkë me t'è ep-u një hov zemre e lëviz valët e ajrit : " kurrë mos u-harrofshi „. Mandej shko mà përpjetë e, kur të mbërrijsh nalt faqes malit, merr me mend se si gjimonte dikur ai vend e si me dhimbë i përlulshin majat ata lisa vigan-da. Zbrit mandej përposhtë e, kur të sosish ke shtëpija, thuej-u fëmijve a shka të kesh **se lu áshit lumnija vetë.**

(1) Në mal të Dibrës s' Epër ndodhet burimi i Doçit e pranë t'ij një përrue i vogël. Aty u-vranë shumë Shqiptarë në luftë kundra Serbëve.

Lajme të Shkollës

Më 13 të Prillit u-mbaruen provimet e stazhit. Kishin ardhun për këtë shumica e rendit '29, si edhe të tjerë prej rendeve të mëparshëm. Për me dhënë aftësin pedagogjike, nuk u-paraqit asnji. Ata qi fituen stazhin janë: Z. Z. Ali Narazani, Banush Zhudi, Fahri I. Agastra, Haki Tahiri, Halim Hodo, Harrun Sefa, Hamdi Gani, Hodo Taçi, Hysni Stringa, Isak Ngurrza, Maksut Milova, Mehmet Qorri, Muhamet Golemi, Rasim Sulejmani, Spiro Popa, Sulejman Goci, Shykri Zejnehoxha, Ymer Luçi e Xhevat Xhafar.

Prej këtyne zotnive Normalisti mbloodhi një ndihmë prej 120 fr. ari. Z. Z. Fahri I. Agastra, Harrun Sefa, Hodo Taçi, Muhamet Golemi e Rasim Sulejmani e ndihmuen Normalistin seicili me nga 10 fr. ari; të tjerët me nga 5 fr. ari. Edhe një herë iu falemi nderit shokvet t'onë për këtë ndihmë. Po ta ndiqshin të gjithë këtë vepër të mirë, na do t'ishim më të çelun e detyrën t'onë, të nisun me qejf, do ta kryejshim më së miri. Borxha në shtypshkrojtë na mbyti, e ata, qi i duem e qi na duen, s' po na vijnë në ndihmë!

Athletisma e lehtë ndërmjet shkollavet të mesme, qi do të bëshesh këtë muej, u-shty për në Vjeshtë.

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare, Z. Spiro Kolea, i dërgoi shokut t'onë, St. Spases, në drejtimin e së përkohshemes, një letër përgëzimi për "S' ka për sen", qi shkroi në Nr. 3 të Normalistit. Na do të vuejmë prej çdo gjaje, "gjërsa të përkëmbet brezi i ri, i cili me të prijturit e zogivet të Normales. ka për të gjetur rrugën e drejtë në punë gjuhe dhe zakonesh kombëtare, thoshte Z. Kolea. Jemi të rij e duem kurdoherë të na japin zemer më të mëdhejt. Kur na përgëzojnë për një punë të vogël, ahëre i vihemi me gjithë qejf një punë më të madhe. Prandaj Z. Koleas i falemi nderit shumë. Dëshirojmë qi prijsvet t'onë, atyne qi, tue dashë të mirën e Atdheut, mundohen të na çojnë në rrugën e drejtë, t'iu ndigjojmë kurdoherë zënin e mirë.

Më 29 Prill u-zhvillue këtu një ndeshje atletike ndërmjet shkollës Teknike dhe shkollës s'onë për kujtim të Friedrich

Fröbelit, pedagogut të lojname të fëmive. Shkolla e jonë vuni për këtë qillim një kupë. Kësaj here fituem na 107 pika kundër 90. Darkën e 29 dhamë një koncert për nder të miqve. Nëndrejtori Z. V. Andoni mbajti një fjalim, me anën e të cilit tregoi rëndësinë e sportit si mjet shoqëues. Foli për Friedrich Fröbelin e më në fund përgëzoi atletet, sepse i filluem lojnat me vllazni e i mbaruen po kështu. Mandej H. Zhiti na shpërtheu se qeshuni tue tregue jetshkrimin e vet si një përrallë.

Pasqyra e lojname

Vrap 100 m: I Gjevori (T). 12 $\frac{3}{5}$ " ; II Xhafa (N). 13" ; III Skuka (T).

Hudhje e topit prej hekuri: I Berisha (N). 11,78 m. ; II Trebicka (T). 11,53 m. III Guri (T). 10,94 m.

Hofje për së nalti: I Sevo (N). 1,58 m. ; II Paci (T). 1,49 m. ; III Paze (T). 1,49

Vrap 1500 m. I Isak (T). 4'48 $\frac{4}{5}$ " ; II Bulaj (T). 4'49" ; III Agimi (N).

Hudhje e diskut : I Shllaku (N). 28,32 m. ; II Berisha (N). 26,01 m. III Trebicka (T). 25,45 m.

Vrapim 400 m. I Bulaj (T). 1'1 $\frac{4}{5}$ " ; II Ruli (N). 1'2" III Xhafa (N).

Hofje për së gjati : I Sevo (N). 5,23 m. ; II Skuka (T). 4,98 m. III Kashari (N). 4,88 m.

Vrap 3000 m. I Isak (T) 10'44 $\frac{3}{5}$ " ; II Vaska (N). III Selenica (N).

Hofje me tri hapa : I Sevo (N). 11,42 $\frac{1}{2}$ m. ; II Sherifi (N). 10,86 m. III Gjevori 10,10 m.

Urdhën sjellse I Shkolla Normale 2,49" II Shkolla Teknike 2'55" ;

Ai qi të do, të kërkon e të ndihmon. Shokut t' onë të vjetër Z. Emin Koplikut '26 i ra rruga të shkoje këndeje e ta shohi Elbasanin; por nuk i u-ndejtë pa i takuem shokët e 'tij e pa shkëlun edhe një herë në pragun e shkollës. Normalistit i dha ndihmën e vet prej 5 fr. ari. I falemi nderit shumë,

Posta e jonë.

Z. Aqif Domini Korçë. Muerëm letrën t'uej dhe pajtimet e gjashtë vetëve (12 fr. ari.) Ju falemi nderit për fjalët, qi shkrueni dhe për munditë, qi bëni për "Normalistin". E kemi provuem me kohë bujarin e fisnikrin t'uej. Zotnive, qi e lënë detyrën e 'tyne ndaj Normalistit, iu falemi nderit shum

Nxënësevet të Normales Femnore Korçë. Muerëm për së dyti 12 fr. ari. u falemi nderit. Ashtu më mirë, ashtu si e keni menduem, ta pagueni Normalistin numër më numër, se me një anë na vini neve në ndihmë e më anë t'jetër s' i lini ndonji barrë veches s' uej.

Z. Sha Afërdita Shahini Boboshticë (Korçë). Ju regjistruem si pajtimtare e ju dërguem gjithë numrat e këtij viti.

Z. Josif Stefi Skrapar. Muerëm letrën t' uej bashkë me listën e pajtimtarve. Ju falemi nderit për fjalët e mira, qi na shkrueni. Frazja e fundit regon sheshazi simpatthin t' uej ndaj ne e dëshirën qi keni për të mos u-shuem drita e jonë e vogël, "Normalisti".

Z. Abdullah Çanga Peshkopi. Letrën e listën e pajtimtarve e muerëm. Ju falemi nderit shumë Lutemi qi, tue bashkuem numrat e shpërndamë prej Z. Muarrem Musës me ata të z. s'uej, të mblihdni pajtimet.

Z. Z. Petër Elezit Mat e Zef Palit Shkodër. Kartolinat t'ueja i muerëm. Ju falemi nderit. Lutemi na dërgoni shkrieme.

Z. Kel Koka Durrës. Muerëm letrën dhe listën e pajtimtarvet. Ju falemi nderit Atyne zotnive, qi nuk u ka vojtun fare Normalisti, ose qi nuk u ka vojtun me rregullë deri sot, u-kërkojmë ndjesë. Kjo ka rrjedhun, nga se nuk i kishim listat.

Z. Nikollë Allkanjari Rroskovec. Muerëm letrën t' uej dhe bëmë, ashtu si na shkruenjshit. Zotni Refat Mehqemes ia kemi dërguem Normalistin në Berat; e dëshim se ishte atje..

Z. Kolë Kozmaqi Shkodër. Kur jeshit këtu shpesh herë e kapshit pendën për Normalistin, por tashti në largesë e kini lënë mbas dore. Lutemi na shkrueni e na dërgoni herë mbas here ndonji përskrim.

Z. Vangjel Nasto Çatistë. Muerëm letrën dhe artikullin t'uej, të cilin do ta botojmë në numrin t' jetër. Ju falemi nderit shum.

Z. Bajram Zoto Kolonjë. Letrën t'uej bashkë me listën e pajtimtarve e muerëm. Ju falemi nderit, sepse, kur ju harrojmë ne, na kujtoni ju.

Revistës Leka Shkodër. Muerëm numrin katër t'asaj së përkohësh meje. Ju falemi nderit shum.

Z. Koço Stefani Ondriçan (Përmet). E muerëm letrën t'uej. Ju falemi nderit për fjalët e mira, qi i shkrueni Normalistit.

Z. Bajram Bica Krumë. Muerëm letrën t'uej edhe të hollat (13 fr. ari.) Ju falemi nderit.